



MINISTRIA PA EMËR

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2026



AUTOR
Arba Ollomani

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	3
2	METODOLOGJIA	3
4	KRONOLOGJIA E PROTESTAVE	12
5	KOMUNIKIMI INSTITUCIONAL GJATË PROTESTAVE	15
6	REAGIMI I INSTITUCIONEVE	21
	GJETJET KRYESORE	25
	REKOMANDIME	26



1 HYRJE

Ky raport ka si synim analizën e aktivitetit të Ministrisë së Mjedisit dhe vendimarrjet e këtij institucioni lidhur me kërkesat mjedisore të artikuluara në protestat e zhvilluara në Shqipëri që nga Maji kundër ndryshimeve në ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë gjatë vitit 2024. Miratimi i këtyre ndryshimeve, i shoqëruar me propozime për zhvillime turistike në zonën e Zvërnecit dhe Parkut Natyror Vjosë–Nartë, u pasua nga protesta të organizuara nga organizata mjedisore, aktivistë dhe komunitetet lokale.

Çështja mori një dimension ndërkombëtar pasi organizata të njohura për mbrojtjen e natyrës, si dhe Parlamenti Europian, shprehën shqetësime mbi ndikimin që këto ndryshime mund të kenë në biodiversitet, respektimin e standardeve evropiane dhe përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Raporti fokusohet në analizimin e reagimit të institucioneve shtetërore, komunikimit publik të përfaqësuesve të qeverisë, masave të ndërmarra nga autoritetet përgjegjëse gjatë protestave, si dhe reagimeve të aktorëve ndërkombëtarë, veçanërisht institucioneve të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i raportit është të dokumentojë mënyrën se si institucionet publike kanë adresuar shqetësimet e ngritura nga organizatat e shoqërisë civile dhe grupet mjedisore, si dhe të vlerësojë nëse procesi i komunikimit publik dhe administrimit të protestave ka respektuar standardet demokratike

2 METODOLOGJIA

Raporti është hartuar mbi bazën e monitorimit sistematik të informacionit publik të disponueshëm gjatë periudhës maj – 31 korrik 2026, me fokus zhvillimin e protestave për zonat e mbrojtura, reagimin e aktorëve institucionalë, zhvillimet ligjore dhe parlamentare, si dhe përputhshmërinë e politikave me standardet evropiane.

Procesi i monitorimit ka përfshirë mbledhjen, verifikimin, sistemimin dhe analizimin e informacionit nga burime të ndryshme publike. Të dhënat janë organizuar në kategori tematike për të mundësuar identifikimin e zhvillimeve kryesore dhe krahasimin e reagimit të aktorëve të ndryshëm gjatë periudhës së monitorimit.

Burimet e përdorura përfshijnë:

- aktet ligjore dhe nënligjore, projektligjet, relacionet dhe dokumentet parlamentare;
- deklaratat dhe qëndrimet zyrtare të Kryeministrit, Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve të tjera publike;



- postimet e publikuara në rrjetet sociale zyrtare të institucioneve dhe drejtuesve të tyre;
- deklaratat dhe reagimet e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave mjedisore;
- raportimet e mediave kombëtare dhe ndërkombëtare;
- dokumentet, raportet, rezolutat dhe rekomandimet e institucioneve të Bashkimit Evropian.

Për analizën e protestave, informacioni është sistemuar në mënyrë kronologjike, duke evidentuar datat, zhvillimet kryesore, kërkesat e protestuesve, reagimet institucionale dhe ndryshimet në natyrën e protestës gjatë periudhës së monitorimit.

Për analizën e komunikimit publik dhe rrjeteve sociale, postimet janë identifikuar dhe kategorizuar sipas përmbajtjes, duke dalluar komunikimin institucional, reagimet e drejtpërdrejta ndaj protestës, përmbajtjet informuese, politike ose ironizuese, si dhe komunikimin lidhur me çështje specifike si Zvërneci dhe zonat e mbrojtura. Për secilën kategori është evidentuar numri i postimeve dhe, kur është e nevojshme, pesha e tyre përqindore ndaj totalit të komunikimit të monitoruar.

Reagimi institucional është vlerësuar duke marrë në konsideratë jo vetëm deklaratat publike, por edhe veprimet konkrete, përfshirë nismat ligjore, shqyrtimin parlamentar, konsultimet, kërkesat dhe përgjigjet për informacion dhe masat e deklaruar nga institucionet.

Ndërkohë, për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet evropiane, është përdorur një qasje krahasuese ndërmjet kuadrit ligjor dhe praktikave shqiptare dhe kërkesave të *acquis communautaire*, me fokus të veçantë të Kapitulli 27, Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, mbrojtja e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura.

Gjetjet janë ndërtuar mbi informacionin e dokumentuar dhe të verifikueshëm, duke bërë dallimin, kur është e nevojshme, ndërmjet fakteve të konstatuara, qëndrimeve të aktorëve dhe interpretimit analitik të të dhënave. Kjo metodologji synon të ofrojë një pasqyrë sa më objektive të zhvillimeve dhe të evidentojë jo vetëm reagimet e institucioneve, por edhe hendekun e mundshëm ndërmjet angazhimeve të deklaruar dhe veprimeve konkrete.

3. KONTEKSTI

3.1 Ndryshimet në ligjin për Zonat e Mbrojtura

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshime në Ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", të propozuara nga Këshilli i Ministrave. Sipas relacionit shoqërues, ndryshimet synonin të krijonin një kuadër më fleksibël për zhvillimin e



aktiviteteve ekonomike, turizmit të qëndrueshëm dhe investimeve strategjike brenda kategorive të caktuara të zonave të mbrojtura.

Ndryshimet u shoqëruan me debat të gjerë publik, pasi organizatat mjedisore argumentuan se dispozitat e reja reduktonin nivelin e mbrojtjes së parqeve kombëtare dhe hapnin mundësi për zhvillime infrastrukturore në territore me vlera të larta natyrore.

Ndryshimet e miratuara në vitin 2024 në Ligjin "Për Zonat e Mbrojtura" përfaqësojnë një nga ndërhyrjet më të debatueshme në legjislacionin mjedisor shqiptar gjatë viteve të fundit. Debat i publik që pasoi miratimin e ligjit nuk u fokusua vetëm te aspektet teknike të menaxhimit të zonave të mbrojtura, por ngriti pyetje më të gjera mbi balancën ndërmjet zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së biodiversitetit dhe përmbushjes së detyrimeve që Shqipëria ka në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Sipas argumenteve të paraqitura nga shumica parlamentare dhe përfaqësuesit e qeverisë, ndryshimet në Ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" synonin krijimin e një kuadri më fleksibël për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, promovimin e turizmit të qëndrueshëm, rritjen e rolit të pushtetit vendor në administrimin e territoreve, harmonizimin e zhvillimit ekonomik me mbrojtjen e natyrës, si dhe thjeshtimin e procedurave për miratimin e projekteve në kategori të caktuara të zonave të mbrojtura. Në këtë këndvështrim, ndryshimet u paraqitën si një instrument për të mundësuar investime të kontrolluara, pa cënuar statusin juridik të zonave të mbrojtura.

Megjithatë, analiza e përmbajtjes së ligjit tregon se ndryshimet nuk kufizohen vetëm në aspektin procedural, por prekin vetë regjimin juridik të mbrojtjes së këtyre territoreve. Konkretisht, ato zgjerojnë gamën e aktiviteteve që mund të lejohen brenda disa kategorive të zonave të mbrojtura, krijojnë mundësi për zhvillimin e infrastrukturës turistike dhe akomoduese, rrisin hapësirën diskrecionale të organeve publike në autorizimin e ndërhyrjeve dhe parashikojnë mekanizma më fleksibël për realizimin e projekteve të zhvillimit ekonomik. Edhe pse ligji vijon të deklarojë mbrojtjen e biodiversitetit si objektiv themelor, mënyra se si janë riformuluar dispozitat krijon një raport të ri ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

Pikërisht ky aspekt ka përbërë edhe thelbin e kundërshtimeve të ngritura nga organizatat mjedisore, ekspertët dhe një pjesë e opozitës parlamentare. Sipas tyre, ndryshimet përfaqësojnë një devijim nga filozofia mbi të cilën ishte ndërtuar ligji i vitit 2017. Ky i fundit kishte si parim themelor ruajtjen e biodiversitetit, ekosistemeve dhe trashëgimisë natyrore, duke e konsideruar zhvillimin ekonomik si një aktivitet të lejueshëm vetëm në masën që nuk cenonte funksionin konservues të zonave të mbrojtura. Ndërkohë, ndryshimet e vitit 2024 perceptohen se e zhvendosin ekuilibrin drejt krijimit të mundësive



për zhvillim ekonomik dhe investime, duke i dhënë këtij objekti një peshë më të madhe në procesin e administrimit të zonave të mbrojtura.

Nga një këndvështrim juridik dhe i politikave publike, kjo përbën ndryshimin më domethënës të ligjit. Nuk bëhet fjalë vetëm për shtimin e aktiviteteve të lejuara apo për thjeshtimin e procedurave administrative, por për një rikonceptim të qëllimit të vetë ligjit. Nëse ligji i vitit 2017 ishte ndërtuar në një farë forme bazuar mbi parimin **"mbrojtja si rregull dhe zhvillimi si përjashtim"**, ndryshimet e vitit 2024 tentojnë të krijojnë një model ku ruajtja e natyrës dhe zhvillimi ekonomik konsiderohen objektiva që duhet të bashkëjetojnë dhe të balancohen. Ky ndryshim ngre pikëpyetje mbi efektivitetin e mekanizmave mbrojtës në afatgjatë, veçanërisht në zona me vlera të larta ekologjike dhe ka qenë arsyeja kryesore pse ndryshimet u kundërshtuan nga organizatat e shoqërisë civile dhe u lidhën me shqetësimet e ngritura nga institucionet e Bashkimit Evropian në kuadër të zbatimit të acquis mjedisor dhe të Kapitullit 27 "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike".

Pavarësisht se ligji parimisht nuk autorizon drejtpërdrejt ndërtimin e resorteve apo infrastrukturës masive, ai krijon bazën ligjore që këto aktivitete të konsiderohen të lejueshme në të ardhmen përmes procedurave administrative dhe vendimeve të institucioneve përgjegjëse.

Shqetësimi kryesor që ngrihet në lidhje me ndryshimet ligjore është se, në praktikë, kufiri ndërmjet konceptit të **"turizmit të qëndrueshëm"** dhe zhvillimit intensiv turistik mund të bëhet i paqartë dhe lehtësisht i kapërcyeshëm, veçanërisht në kushtet e presionit për realizimin e investimeve strategjike. Edhe pse ligji parashikon se çdo ndërhyrje duhet t'i nënshtrohet procedurave të vlerësimit mjedisor dhe të respektojë kriteret për mbrojtjen e biodiversitetit, efektiviteti i këtyre mekanizmave varet nga zbatimi praktik, transparenca e procesit të vendimmarrjes dhe kapaciteti i institucioneve përgjegjëse për të ushtruar kontroll të pavarur dhe efektiv. Në mungesë të këtyre garancive, ekziston rreziku që koncepti i "zhvillimit të qëndrueshëm" të interpretohet në mënyrë të zgjeruar, duke krijuar hapësira për ndërhyrje që mund të ndikojnë negativisht në integritetin ekologjik të zonave të mbrojtura.

Nga analiza e ndryshimeve ligjore rezulton se debati nuk lidhet vetëm me dispozita të veçanta të ligjit, por me vetë filozofinë e administrimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri. Në thelb, diskutimi përqendrohet tek mënyra se si duhet të balancohen dy objektiva me rëndësi publike, si ruajtja afatgjatë e trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit, nga njëra anë, dhe nxitja e zhvillimit ekonomik përmes investimeve dhe turizmit, nga ana tjetër.

Në këtë kuadër, përplasja zhvillohet ndërmjet dy qasjeve kryesore:



- **Qasja e konservimit**, sipas së cilës zonat e mbrojtura kanë si funksion parësor ruajtjen e biodiversitetit, habitateve natyrore dhe proceseve ekologjike. Sipas kësaj qasjeje, çdo aktivitet ekonomik duhet të ketë karakter përjashtimor dhe të lejohet vetëm kur provohet se nuk çënon objektivat e mbrojtjes. Kjo filozofi është në përputhje me parimin e kujdesit (precautionary principle), i cili përbën një nga parimet themelore të së drejtës mjedisore evropiane dhe ndërkombëtare.
- **Qasja e zhvillimit të qëndrueshëm**, sipas së cilës mbrojtja e natyrës dhe zhvillimi ekonomik nuk janë domosdoshmërisht objektiva kundërthënëse. Sipas kësaj perspektive, investimet, infrastruktura turistike dhe aktivitetet ekonomike mund të zhvillohen edhe brenda kategorive të caktuara të zonave të mbrojtura, për sa kohë ato i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, respektojnë kriteret ligjore dhe garantohen mekanizma efektivë monitorimi dhe kontrolli.

Në praktikë, sfida nuk qëndron vetëm në formulimin e dispozitave ligjore, por në mënyrën se si ato do të zbatohen nga institucionet përgjegjëse. Për këtë arsye, debati mbi ndryshimet e ligjit nuk kufizohet në çështjen nëse investimet duhet ose jo të lejohen në zonat e mbrojtura, por nëse kuadri i ri ligjor ofron garanci të mjaftueshme që objektivi parësor i mbrojtjes së biodiversitetit të mos zbehet përballë interesave ekonomike. Pikërisht ky ekuilibër përbën një nga elementet më të rëndësishme të *acquis communautaire* në fushën e mjedisit dhe të standardeve që Shqipëria duhet të përmbushë në kuadër të Kapitullit 27, Mjedi dhe Ndryshimet Klimatike. Në këtë kontekst, mënyra se si do të zbatohen ndryshimet ligjore do të jetë përcaktuese për të vlerësuar nëse ato arrijnë të harmonizojnë zhvillimin ekonomik me mbrojtjen e natyrës, apo nëse do të çojnë në dobësimin gradual të regjimit të mbrojtjes së zonave të mbrojtura.

Pikërisht tensioni ndërmjet këtyre dy modeleve shpjegon pse ndryshimet në ligj kanë prodhuar një nivel kaq të lartë kundërshtimi publik dhe reagimi ndërkombëtar.

3.2 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

Ligji nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" u kundërshtua nga organizata mjedisore, ekspertë të biodiversitetit, deputetë të opozitës dhe më vonë u bë objekt shqyrtimi edhe nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2025.

Në Vendimin nr. 45, datë 31.07.2025, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ndryshimeve në Ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", duke arsyetuar se ligji objekt shqyrtimi ka natyrën e një ligji kuadër dhe, si i tillë, nuk është i vetëzbatueshëm dhe nuk prodhon pasoja të drejtpërdrejta mbi zonat e mbrojtura. Sipas Gjykatës, ligji vetëm përcakton kuadrin e përgjithshëm ligjor për administrimin e këtyre zonave, ndërsa efektet konkrete do të materializohen vetëm përmes akteve nënligjore, kryesisht vendimeve të



Këshillit të Ministrave, të cilat do të përcaktojnë regjimin dhe rregullat specifike për secilën zonë të mbrojtur.

Në këtë kontekst, Gjykata vlerësoi se pretendimet e kërkuarve dhe të subjekteve të interesuara, sipas të cilave ndryshimet ligjore do të mundësonin ndërtimin e resorteve turistike dhe hoteleve me pesë yje në zonat e mbrojtura, mbeteshin hipotetike dhe nuk mbështeteshin në pasoja konkrete e të verifikueshme. Për rrjedhojë, ajo çmoi se nuk ishte e mundur të konstatohej në këtë fazë një cënim i drejtpërdrejtë i mjedisit apo i karakteristikave të zonave të mbrojtura, pasi nuk kishte ende vendime konkrete që autorizonin ndërhyrje të tilla.

Gjykata theksoi gjithashtu se kontrolli i përputhshmërisë së ligjit me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA), veçanërisht me detyrimet që burojnë nga neni 108 i saj në fushën e mbrojtjes së mjedisit, si dhe me konventat ndërkombëtare përkatëse, përfshirë Konventën e Bernës, Konventën e Ramsarit dhe Konventën për Diversitetin Biologjik (Rio de Janeiro), mund të realizohet vetëm pas miratimit të akteve konkrete të zbatimit të ligjit. Neni 108 i MSA-së parashikon se: *“Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.”* Në këtë kuadër, Gjykata vlerësoi se vetëm pas miratimit të vendimeve të Këshillit të Ministrave ose akteve të tjera administrative që zbatojnë ligjin do të jetë e mundur të vlerësohet nëse këto akte respektojnë standardet kushtetuese dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë për mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar në këtë arsyetim, Gjykata arriti në përfundimin se pretendimet për papajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe për cënimin e trashëgimisë natyrore dhe identitetit kombëtar, ishin haptazi të pabazuara, pasi mbështeteshin në pasoja të mundshme dhe jo në efekte juridike konkrete të ligjit. Në këtë mënyrë, Gjykata e zhvendosi kontrollin kushtetues nga vetë ligji tek aktet e ardhshme të zbatimit, duke lënë të hapur mundësinë që këto të fundit të kundërshtohen nëse do të rezultojnë në kundërshtim me Kushtetutën ose me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Pavarësisht kundërshtimeve të kryera, ligji vazhdoi të mbetej në fuqi pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2025.

3.3 Përputhshmëria me standardet e Bashkimit Evropian

Përputhshmëria e legjislacionit shqiptar për zonat e mbrojtura me *acquis communautaire* përbën një element thelbësor të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë. Në kuadër të Kapitullit 27, Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, Shqipëria ka detyrimin jo vetëm të përafrojë legjislacionin e saj me të drejtën e Bashkimit Evropian, por edhe të garantojë zbatimin efektiv të standardeve evropiane për mbrojtjen e biodiversitetit, habitateve natyrore



dhe zonave të mbrojtura. Për këtë arsye, çdo ndryshim në kuadrin ligjor që rregullon administrimin e zonave të mbrojtura vlerësohet edhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit.

Në këtë kontekst, jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, veçanërisht në çështjen *Komisioni kundër Gjermanisë (C-57/89)*, ka vendosur një standard të rëndësishëm sipas të cilit zvogëlimi ose degradimi i një zone të mbrojtur mund të justifikohet vetëm në rrethana krejtësisht të jashtëzakonshme. Sipas kësaj jurisprudence, interesat ekonomike, turistike apo rekreative nuk përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të cenuar nivelin e mbrojtjes së habitateve dhe specieve, pasi ruajtja e biodiversitetit përbën një interes publik me përparësi.

Një komponent tjetër i rëndësishëm i *acquis* mjedisor është Konventa e Aarhus-it, e cila është pjesë e kuadrit evropian të qeverisjes mjedisore dhe garanton të drejtën e publikut për akses në informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe akses në drejtësi në çështjet mjedisore. Konventa kërkon që publiku të informohet dhe të përfshihet në mënyrë efektive jo vetëm për projektet konkrete, por edhe gjatë hartimit të akteve normative që mund të kenë ndikim në mjedis. Këto standarde plotësohen edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka theksuar detyrimin e autoriteteve për të siguruar informacion të plotë dhe të besueshëm, si dhe mundësi reale për pjesëmarrje të komuniteteve të prekura përpara miratimit të projekteve me ndikim mjedisor.

Në kuadër të Kapitullit 27, Bashkimi Evropian nuk vlerëson vetëm ndryshimin formal të legjislationit, por edhe respektimin në praktikë të parimeve të parandalimit, mosdegradimit të mjedisit, transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut.

Për këtë arsye, mënyra se si Shqipëria harton, miraton dhe zbaton legjislationin për zonat e mbrojtura përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e progresit të saj në fushën e mjedisit dhe në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në këtë kuptim, çdo debat mbi ndryshimet në Ligjin për Zonat e Mbrojtura nuk lidhet vetëm me të drejtën e brendshme, por edhe me aftësinë e Shqipërisë për të respektuar standardet e *acquis communautaire* dhe angazhimet e marra në kuadër të negociatave për Kapitullin 27.

3.4 Praktika e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian

Përtej kuadrit ligjor kombëtar, analiza e kësaj çështjeje kërkon edhe një vështrim në praktikën e Bashkimit Evropian, e cila ka zhvilluar standarde të konsoliduara mbi marrëdhënien që duhet të ketë midis mbrojtjes së zonave të mbrojtura dhe zhvillimit ekonomik. Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian shërben si një mjet ndihmës në përcaktimin e vijës ndarëse ndërmjet ndërhyrjeve të lejueshme dhe atyre që cenojnë objektivat



e ruajtjes së biodiversitetit, duke ofruar një pikë referimi të rëndësishme edhe për vlerësimin e kuadrit ligjor shqiptar në funksion të përafrimit me *acquis communautaire*.

Në çështjen ***Commission v. Germany (C-57/89)***, Gjykata theksoi se zvogëlimi ose dobësimi i mbrojtjes së zonave të mbrojtura nuk mund të justifikohet mbi baza ekonomike apo turistike. Sipas Gjykatës, interesat e ruajtjes së biodiversitetit dhe habitateve natyrore kanë përparësi ndaj interesave të zhvillimit ekonomik, ndërsa çdo përjashtim duhet të mbështetet vetëm në rrethana krejtësisht të jashtëzakonshme.

Në çështjen ***Waddenvereniging dhe Vogelbeschermingsvereniging (C-127/02)***, Gjykata vendosi se një projekt mund të miratohet vetëm nëse, pas një vlerësimi të plotë shkencor, provohet se ai nuk cënon integritetin e zonës së mbrojtur. Në rast se ekziston një dyshim i arsyeshëm shkencor mbi ndikimin e projektit, autoritetet janë të detyruara të zbatojnë parimin e kujdesit (*precautionary principle*) dhe të mos autorizojnë realizimin e tij.

Në vijim, në çështjen ***Sweetman and Others (C-258/11)***, Gjykata sqaroi se edhe humbja ose degradimi i pjesshëm i një habitati të mbrojtur mund të konsiderohet cënim i integritetit të zonës, nëse prek karakteristikat ekologjike që justifikojnë statusin e saj të mbrojtjes. Për rrjedhojë, nuk kërkohet shkatërrimi i plotë i një zone që një projekt të konsiderohet i papajtueshëm me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Këto vendime konfirmojnë se mbrojtjes së biodiversitetit i është dhënë një peshë mbizotëruese në raport me interesat e zhvillimit ekonomik, duke e konsideruar ruajtjen e integritetit ekologjik të zonave të mbrojtura si kriterin kryesor mbi të cilin duhet të mbështetet çdo vendimmarrje publike. Zhvillimi ekonomik dhe investimet mund të lejohen vetëm nëse provohet, mbi baza shkencore dhe në përputhje me parimin e kujdesit, se ato nuk cenojnë integritetin ekologjik të këtyre zonave. Kjo qasje përbën një standard të rëndësishëm edhe për Shqipërinë në kuadër të përafrimit me *acquis communautaire*.

3.5 Kundërshtimet e shoqërisë civile

Menjëherë pas publikimit të projektligjit, një numër organizatash mjedisore dhe organizatash të shoqërisë civile shprehën kundërshtimin e tyre ndaj amendamenteve.

Kundërshtimet kryesore u fokusuan në:

- uljen e nivelit të mbrojtjes ligjore të zonave të mbrojtura;
- mundësinë e zhvillimit të investimeve që çenojnë zona me rëndësi të veçantë ekologjike;
- mungesën e konsultimeve efektive me publikun dhe komunitetin shkencor;



- rrezikun që ndryshimet të krijonin precedent për zhvillime të tjera në terriore të mbrojtura.

Organizatrat kërkuar tërheqjen e projektligjit, zhvillimin e një procesi të ri konsultimi publik dhe respektimin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Më 20 maj 2026, një koalicion prej mbi 40 organizatash të shoqërisë civile, mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm publikoi një deklaratë të përbashkët drejtuar Kryeministrit, Ministrit të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, duke kërkuar pezullimin e menjëhershëm të çdo ndërhyrjeje ndërtimore në Zonën e Mbrojtur Pishë Poro–Nartë.

Organizatrat theksuan se Pishë Poro–Nartë përbën një nga ekosistemet bregdetare më të rëndësishme në Shqipëri, me status të mbrojtur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (Emerald, IBA, KBA dhe pjesë e korridorit Adriatic Flyway). Zona strehon rreth 250 specie shpendësh, përfshirë specie migratore me rëndësi ndërkombëtare, si dhe ofron shërbime thelbësore ekosistemike.

Sipas deklaratës, monitorimet në terren kanë evidentuar ndërhyrje me mjete të mekanizuara që kanë shkaktuar degradim të habitateve natyrore, fragmentim të pyjeve dhe dunave ranore, humbje të vegjetacionit dhe rrezikim të biodiversitetit. Gjithashtu, organizatat pretendojnë se në zonë janë raportuar leje për komplekse turistike, hapje rrugësh të reja dhe zhvillime infrastrukturore pa transparencë të mjaftueshme, pa konsultim publik dhe pa publikimin e dokumentacionit përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Deklarata argumenton se këto ndërhyrje mund të jenë në kundërshtim me legjislacionin kombëtar për zonat e mbrojtura, mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetin dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, si edhe me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Organizatat i referohen gjithashtu nenit 202/b të Kodit Penal, që lidhet me dëmtimin e habitateve në zona të mbrojtura.

Në përfundim, nënshkruesit kërkuar:

- ndalimin e menjëhershëm të çdo aktiviteti që dëmtton zonën e mbrojtur;
- transparencë të plotë mbi projektet dhe lejet e ndërtimit;
- verifikim të pavarur të ligjshmërisë së ndërhyrjeve;
- respektimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe konsultimit publik;



- ndërhyrjen e institucioneve ligjzbatuese për ndalimin e çdo aktiviteti të paligjshëm. Gjithashtu, u bëhet thirrje Bashkimit Evropian dhe partnerëve ndërkombëtarë të monitorojnë situatën dhe të kërkojnë respektimin e detyrimeve mjedisore të Shqipërisë.

4 KRONOLOGJIA E PROTESTAVE

Pas miratimit të ndryshimeve ligjore, reagimet e para publike nisën që në periudhën pas miratimit të ligjit, fillimisht përmes protestave më të vogla dhe aktiviteteve të organizuara nga organizatat mjedisore dhe grupe të tjera të interesuara. Këto reagime shprehnin shqetësimin lidhur me ndikimin e ndryshimeve në regjimin e mbrojtjes së zonave të mbrojtura dhe kërkonin rishikimin e kuadrit të ri ligjor.

Në vijim, reagimi qytetar u intensifikua dhe protestat morën një shtrirje më të gjerë, duke u zhvilluar në Tiranë dhe në zona të tjera të vendit.

Pjesëmarrësit kërkuan:

- shfuqizimin e amendamenteve;
- pezullimin e çdo procedure që lidhej me zhvillimin e investimeve në zonat e mbrojtura;
- transparencë më të madhe institucionale;
- respektimin e standardeve evropiane për mbrojtjen e biodiversitetit.

Protestat u karakterizuan nga pjesëmarrja e organizatave mjedisore, aktivistëve, akademikëve, qytetarëve dhe përfaqësuesve të komuniteteve lokale, duke e kthyer çështjen e zonave të mbrojtura në një nga debatet më të rëndësishme publike të periudhës.

Gjatë një proteste lokale në Zvërnec, një protestues përplasët fizikisht me punonjës të sigurisë private. Pamjet e incidentit qarkullojnë gjerësisht në rrjetet sociale dhe shërbejnë si katalizator për mobilizimin qytetar.

Pas reagimeve të para ndaj ndryshimeve ligjore, mobilizimi qytetar u zhvillua gradualisht, duke kaluar nga protesta dhe aksione të kufizuara të organizatave mjedisore në një reagim më të gjerë publik. Intensifikimi i protestave u ndikua edhe nga zhvillimet konkrete në zona të mbrojtura, veçanërisht nga shqetësimet lidhur me ndërhyrjet dhe projektet e zhvillimit në territor.

Kronologjia e mëposhtme paraqet zhvillimin e protestave dhe reagimeve publike gjatë periudhës së monitorimit, duke evidentuar momentet kryesore, kërkesat e protestuesve dhe reagimin e institucioneve. Përveç dimensionit mjedisor, kjo kronologji synon të evidentojë edhe mënyrën se si protesta u zgjerua gradualisht në një debat më të gjerë mbi transparencën, vendimmarrjen publike, përdorimin e territorit dhe modelin e zhvillimit.



20 maj 2026 – Deklarata e organizatave të shoqërisë civile

Më 20 maj 2026, mbi 40 organizata të shoqërisë civile dhe organizata mjedisore publikuan një deklaratë të përbashkët, përmes së cilës kërkuan pezullimin e menjëhershëm të çdo ndërhyrjeje në Zonën e Mbrojtur Pishë Poro–Nartë. Sipas GreenAL Network, ndërhyrjet e konstatuara në terren rrezikojnë habitatet natyrore, biodiversitetin dhe ishin në kundërshtim me detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

21 maj 2026 – Thirrja për protestë

Më 21 maj 2026, PPNEA u bëri thirrje qytetarëve të merrnin pjesë në protestën e planifikuar më 26 maj përpara Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke kërkuar ndalimin e ndërhyrjeve në Vjosa–Nartë dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura.

26 maj 2026 – Protesta para Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Më 26 maj 2026, aktivistë mjedisorë, organizata të shoqërisë civile dhe qytetarë protestuan përpara Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Sipas PPNEA, protestuesit kërkuar pezullimin e menjëhershëm të punimeve, publikimin e dokumentacionit të projektit dhe respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e zonave të mbrojtura.

30 maj 2026 – Përplasjet në Zvërnec

Më 30 maj 2026, gjatë një proteste në Zvërnec, u regjistruan përplasje ndërmjet protestuesve dhe punonjësve të sigurisë private. Sipas Reuters, incidenti shënoi një pikë kthese në mobilizimin qytetar, pasi pamjet e dhunës ndaj protestuesve u shpërndanë gjerësisht në media dhe rrjetet sociale.

Fillimi i qershorit 2026 – Zgjerimi i protestave

Në ditët e para të qershorit, protestat u zgjeruan në Tiranë dhe qytete të tjera të vendit. Sipas Deutsche Welle, demonstruesit kërkuar pezullimin e projekteve turistike në zonat e mbrojtura, rishikimin e ndryshimeve në Ligjin për Zonat e Mbrojtura dhe respektimin e procedurave të konsultimit publik.

Qershor 2026 – Konsolidimi i protestës

Gjatë muajit qershor, protesta mori përmasa më të gjera dhe u mbështet nga organizata të shumta vendase dhe ndërkombëtare. Sipas Citizens.al, mobilizimi evoluoi nga një kundërshtim ndaj ndërhyrjeve në Pishë Poro–Nartë në një debat më të gjerë mbi mbrojtjen e mjedisit, transparencën institucionale dhe respektimin e standardeve evropiane.

Korrik 2026 – Përshkallëzimi i protestave

Gjatë muajit korrik, protestat vijuan çdo ditë përpara Kryeministrisë dhe në ditë të caktuara para Parlamentit të Shqipërisë. Sipas Reuters, në disa raste pati përplasje ndërmjet protestuesve dhe Policisë së Shtetit, e cila përdori gaz lotsjellës dhe autobotë me ujë për shpërndarjen e turmës.



Analiza e evolucionit të protestës

Protestat kundër ndryshimeve në Ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" dhe zhvillimeve të planifikuara në territoret me status të veçantë mbrojtjeje nisën fillimisht si një kauzë mjedisore, e fokusuar në mbrojtjen e ekosistemeve natyrore, veçanërisht të zonës së Pishë Poro–Nartë, si dhe në kundërshtimin e ndërhyrjeve turistike dhe projekteve zhvillimore që perceptoheshin si kërcënim për biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore. Në këtë fazë, kërkesat kryesore lidhenin me respektimin e legjislacionit mjedisor, garantimin e transparencës institucionale, zhvillimin e konsultimeve publike dhe ruajtjen e integritetit të zonave të mbrojtura.

Me kalimin e kohës, protesta filloi të tejkalojë dimensionin fillestar mjedisor dhe të shndërrohet në një mobilizim qytetar me kërkesa më të gjera politike dhe shoqërore. Rritja e pjesëmarrjes nga qytetarë, aktivistë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë, akademikë dhe diaspora solli zgjerimin e objektivave të lëvizjes. Përtej mbrojtjes së zonave të mbrojtura, protestuesit kërkuan anulimin e ndryshimeve ligjore që preknin regjimin e mbrojtjes së këtyre territoreve, duke argumentuar se ato cenonin interesin publik dhe krijonin mundësi për shfrytëzim të burimeve natyrore në favor të interesave private.

Në këtë fazë, pakënaqësia qytetare u zgjerua edhe ndaj politikave të tjera qeveritare që perceptoheshin si pjesë e të njëjtit model vendimmarrjeje. Një nga çështjet e përfshira në diskursin e protestës ishte kërkesa për shfuqizimin e "Paketës së Maleve", e cila nga kundërshtarët u konsiderua si një mekanizëm që mund të rrezikonte pronat publike dhe zonat me vlera natyrore përmes zhvillimeve të pakontrolluara. Në këtë mënyrë, protesta filloi të artikulojë një kritikë më të gjerë ndaj mënyrës së menaxhimit të territorit, politikave të zhvillimit dhe marrëdhënies ndërmjet institucioneve publike dhe interesave private.

Paralelisht me zgjerimin e kauzave, një pjesë e protestuesve kaluan nga kërkesat konkrete institucionale drejt kërkesave me karakter politik, duke kërkuar dorëheqjen e qeverisë dhe një ndryshim më të thellë të mënyrës së qeverisjes. Kjo shënoi një transformim të rëndësishëm të protestës, nga një reagim kundër një vendimi specifik ligjor, në një lëvizje që shprehte pakënaqësi ndaj klasës politike dhe kërkonte një rikonfigurim të marrëdhënies mes qytetarëve dhe institucioneve shtetërore.

Në këtë proces transformimi, simbolika e flamingos fitoi një rol qendror. Fillimisht e lidhur me mbrojtjen e ekosistemit të lagunave dhe biodiversitetit, flamingoja u shndërrua gradualisht në simbolin e rezistencës qytetare. Ajo filloi të përfaqësonte jo vetëm mbrojtjen e natyrës, por edhe kundërshtimin ndaj politikave të perceptuara si të padrejta dhe kërkesën për ndryshim. Për shumë pjesëmarrës, simboli i flamingos u konsiderua si një pikë referimi e një



“revolucion i qytetar”, duke shënuar kalimin nga një kauzë sektoriale në një lëvizje me dimension kombëtar të quajtur “revolucion i flamingo”.

Organizimi i protestave u karakterizua nga një strukturë kryesisht horizontale dhe spontane, ku rrjetet sociale luajtën rol të rëndësishëm në mobilizimin e qytetarëve, koordinimin e aktiviteteve dhe përhapjen e mesazheve të lëvizjes. Përmes platformave online, protesta arriti të bashkojë individë dhe grupe me interesa të ndryshme, duke krijuar një narrativë të përbashkët rreth mbrojtjes së interesit publik, transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Në tërësi, evolucioni i kësaj proteste reflekton një kalim nga një kauzë e fokusuar në mbrojtjen e mjedisit drejt një lëvizjeje qytetare me dimension politik. Kërkesat për anulimin e ndryshimeve ligjore, shfuqizimin e politikave të kundërshtuara si “Paketa e Maleve” dhe, më tej, kërkesa për dorëheqjen e qeverisë, tregojnë zgjerimin gradual të pakënaqësisë nga një çështje konkrete mjedisore drejt një debati më të gjerë mbi qeverisjen, transparencën dhe kontrollin qytetar mbi vendimmarrjen publike. Simboli i flamingos u bë shprehje e këtij transformimi, duke përfaqësuar njëkohësisht mbrojtjen e natyrës dhe kërkesën për ndryshim shoqëror e politik.

5**KOMUNIKIMI INSTITUCIONAL GJATË PROTESTAVE**

Gjatë periudhës së protestave, komunikimi institucional përbënte një nga dimensionet kryesore përmes të cilit institucionet publike shprehën qëndrimin e tyre ndaj shqetësimeve të ngritura nga qytetarët dhe organizatat mjedisore. Në një situatë ku debati për zonat e mbrojtura u shoqërua me kundërshtime të forta publike, mënyra, shpeshtësia dhe përmbajtja e komunikimit institucional morën rëndësi të veçantë për informimin e publikut dhe adresimin e shqetësimeve të protestuesve.

5.1 Analiza e komunikimit të Kryeministrit në Instagram/Facebook gjatë periudhës së protestave 20 maj-31 korrik

Gjatë periudhës së monitorimit, komunikimi i Kryeministrit në Instagram dhe Facebook u karakterizua nga një prani e konsiderueshme e përmbajtjeve që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me protestat për zonat e mbrojtura. Në total janë identifikuar 119 postime, nga të cilat 56 në Instagram dhe 63 në Facebook.

Në Instagram, kategoria dominuese ishte ajo e postimeve me meme ose komente ironizuese ndaj protestuesve, me 33 postime, që përbëjnë 58.9% të komunikimit të monitoruar. Kjo ndiqet nga shembujt e projekteve ose modeleve të turizmit elitare, me 7 postime (12.5%), dhe reagimet e drejtpërdrejta ndaj protestave, me 7 postime (12.5%). Postimet sqaruese për “Paketën e Maleve” përbëjnë 4 postime (7.1%), ndërsa reagimet mbi




situatën në Zvërnec 3 (5.4%). Vetëm 2 postime (3.6%) lidhen me institucionet dhe takimet evropiane në fushën e mjedisit.

Në Facebook, tendenca është e ngjashme. Nga 63 postime të monitoruara, 38 postime (60.3%) përmbajnë meme ose komente ironizuese ndaj protestuesve. Reagimet e drejtpërdrejta ndaj protestave përbëjnë 11 postime (17.5%), ndërsa 7 postime (11.1%) paraqesin shembuj të projekteve ose modeleve të turizmit elitë. Postimet sqaruuese për “Paketën e Maleve” janë 3 (4.8%), ndërsa reagimet mbi Zvërnecin dhe postimet për institucionet/takimet evropiane janë nga 2 secila (3.2%).

Në tërësi, të dhënat tregojnë një tendencë të qartë të komunikimit të Kryeministrit drejt komentimit, kundërshtimit dhe goditjes publike të protestuesve, më shumë sesa drejt shpjegimit të detajuar të çështjeve mjedisore që qëndronin në themel të protestave.

Grafiku 1. Komunikimi i Kryeministrit gjatë protestës



Burimi: Përpunuar nga autori mbi bazën e të dhënave të Instagram dhe Facebook

5.2 Analiza e komunikimit të Ministrisë së Mjedisit në Instagram/Facebook gjatë periudhës së protestave

Gjatë periudhës së monitorimit, komunikimi i Ministrisë së Mjedisit në Instagram dhe Facebook është fokusuar kryesisht në informimin mbi aktivitetet, punën institucionale dhe takimet në fushën e mjedisit. Në ndryshim nga komunikimi i Kryeministrit, nuk janë evidentuar postime të drejtpërdrejta që lidhen me protestën ose protestuesit.


Në Instagram janë identifikuar gjithsej 34 postime. Prej tyre, 22 postime (64.7%) lidhen me punët dhe aktivitetet në fushën e mjedisit, 9 postime (26.5%) me takime dhe informacione institucionale, ndërsa 3 postime (8.8%)



me situatën në Zvërnec. Nuk është evidentuar asnjë postim i drejtpërdrejtë mbi protestën apo protestuesit.

Në Facebook janë identifikuar gjithsej 22 postime. 13 prej tyre (59.1%) lidhen me punët dhe aktivitetet në fushën e mjedisit, 8 (36.4%) me takime dhe informacione institucionale, ndërsa 1 postim (4.5%) lidhet me situatën në Zvërnec. Edhe në këtë platformë nuk janë evidentuar postime të drejtpërdrejta mbi protestën ose protestuesit.

Grafiku 2. Komunikimi i Ministrisë së Mjedisit gjatë protestës



Burimi: Përpunuar nga autori mbi bazën e të dhënave të Instagram/Facebook

5.3 Analiza e komunikimit të Ministrit të Mjedisit në Instagram/Facebook gjatë periudhës së protestave


Nga monitorimi rezulton se komunikimi i Ministrit të Mjedisit në Facebook dhe Instagram ka qenë në masë të madhe i njëjtë, me tema dhe përmbajtje të ngjashme në të dyja platformat. Kjo tregon një qasje të unifikuar në përcjelljen e mesazheve publike, ku të dyja rrjetet sociale janë përdorur kryesisht për të komunikuar të njëjtin qëndrim.

Gjatë periudhës së monitorimit, komunikimi i Ministrit të Mjedisit në Instagram u përqendrua kryesisht te aktiviteti institucional. Nga 47 postime të monitoruara, 20 postime (42,6%) lidhen me punët dhe aktivitetet në fushën e mjedisit, ndërsa 9 postime (19,1%) lidhen me takime në fushën e mjedisit. 4 postime (8,5%) iu referuan situatës në Zvërnec, ndërsa 14 postime (29,8%) ishin repostime të përmbajtjeve të Kryeministrit që lidhen drejtpërdrejt me protestën ose protestuesit.



Në tërësi, komunikimi i Ministrit mbetet i orientuar drejt prezantimit të aktivitetit institucional, ndërsa protesta përbën rreth 30% të komunikimit të monitoruar, kryesisht përmes ripublikimit të përmbajtjeve të Kryeministrit.

Grafiku 3. Komunikimi i Ministrit të Mjedisit gjatë protestës



Burimi: Përpunuar nga autori mbi bazën e të dhënave të Instagram/Facebook

5.4. Krahassimi i komunikimit të Kryeministrit dhe Ministrit të Mjedisit

Analiza e komunikimit në Instagram gjatë periudhës 20 maj – 31 korrik 2026 tregon një diferencë të dukshme ndërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mjedisit në mënyrën se si është trajtuar protesta dhe çështja e zonave të mbrojtura.

Krahassimi tregon një ndryshim të qartë në mënyrën e komunikimit. Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj ka ndjekur kryesisht një qasje institucionale, ndërsa Kryeministri një qasje më politike dhe konfrontuese ndaj protestave dhe protestuesve.

Ministri ka publikuar gjithsej 47 postime, nga të cilat 20 (42,6%) lidhen me aktivitetet mjedisore dhe 9 (19,1%) me takime në fushën e mjedisit. Ndërkohë, 14 postime (29,8%) lidhen me protestat dhe protestuesit. Nga këto, vetëm 2 postime janë përmbajtje origjinale të Ministrit, ndërsa 12 janë ripostime të Kryeministrit. Për më tepër, 4 postime (8,5%) trajtojnë në mënyrë specifike çështjen e Zvërnecit.

Në ndryshim, Kryeministri ka publikuar 119 postime, me 71 postime (59,7%) që përmbajnë meme ose komente ironizuese ndaj protestuesve dhe 18 postime (15,1%) me reagime të drejtpërdrejta ndaj protestave. Kështu, ndërsa komunikimi i Ministrit fokusohet kryesisht te aktiviteti institucional, komunikimi i Kryeministrit është përqendruar më shumë te protestat, protestuesit dhe debati politik rreth tyre.

Në përmbledhje, Ministri Sofjan Jaupaj komunikon kryesisht aktivitetin e institucionit, ndërsa Kryeministri Edi Rama komunikon dhe pozicionohet mbi konfliktin politik të krijuar nga protestat.

Krahassuar me Ministrin Jaupaj, Kryeministri Rama ka qenë kështu aktori kryesor i komunikimit politik të qeverisë ndaj protestës. Ndërsa Ministri ka ruajtur një profil më institucional dhe teknik, Kryeministri ka përdorur një



komunikim më të drejtpërdrejtë, politik dhe në shumë raste ironizues ndaj protestuesve. Kjo diferencë është e dukshme edhe në vetë strukturën e komunikimit: Ministri e ka trajtuar protestën në mënyrë sporadike, ndërsa Kryeministri e ka bërë atë një temë të përsëritur të komunikimit të tij publik.

Një tjetër element që bie në sy është se komunikimi i Ministrisë nuk shfaqet si një kanal alternativ për të shpjeguar në mënyrë të detajuar çështjet mjedisore që qëndrojnë në themel të protestës. Përkundrazi, në aspektin e komunikimit publik, një pjesë e mesazhit të Ministrit amplifikon qëndrimin e Kryeministrit.

Në të njëjtën kohë, komunikimi i Kryeministrit është karakterizuar nga një prani shumë më e madhe e përmbajtjes që lidhet me mbrojtjen e qëndrimit të qeverisë dhe kundërshtimin e narrativës së protestuesve, sesa me një shpjegim të detajuar teknik të shqetësimeve mjedisore.

Në këtë kuptim, ekziston një asimetri e qartë në komunikimin institucional: Ministri i Mjedisit komunikon kryesisht përmes aktivitetit institucional dhe projekteve mjedisore, ndërsa Kryeministri merr përsipër komunikimin politik dhe narrativën publike mbi protestën. Kjo bën që qëndrimi i qeverisë ndaj protestës të jetë më i artikuluar nga Kryeministri sesa nga institucioni përgjegjës për politikën mjedisore.

Kjo diferencë është e rëndësishme sepse ngre pyetjen nëse komunikimi institucional mbi një konflikt të natyrës mjedisore ka qenë i orientuar mjaftueshëm drejt informimit dhe adresimit të shqetësimeve konkrete, apo nëse pjesa kryesore e komunikimit publik është zhvendosur drejt mbrojtjes politike të qëndrimit të qeverisë dhe delegjitimitit të protestës.

Të dhënat tregojnë se Kryeministri ka pasur peshën kryesore në reagimin publik ndaj protestës, ndërsa Ministri i Mjedisit ka mbajtur një profil më të kufizuar dhe institucional. Fakti që dy nga 14 postimet e Ministrit që lidhen me protestën janë ripostime të Kryeministrit e forcon këtë përfundim dhe sugjeron se komunikimi i Ministrisë nuk ka funksionuar si një kanal i pavarur për adresimin e debatit mjedisor, por pjesërisht si një zgjatim i narrativës së komunikimit të Kryeministrit.

Një nga gjetjet më të rëndësishme të monitorimit lidhet me mungesën e një komunikimi të drejtpërdrejtë dhe të pavarur të Ministrit të Mjedisit për një çështje që lidhet drejtpërdrejt me fushën e tij të përgjegjësisë. Ndërkohë që protestat për zonat e mbrojtura dhe veçanërisht debati për Zvernecin përbënin një çështje të rëndësishme mjedisore dhe institucionale, Ministri nuk rezultoi të ketë zhvilluar dalje publike apo reagime të veta të dedikuara për adresimin e shqetësimeve të protestuesve.

Në kontrast, Kryeministri ka pasur një angazhim shumë më të dukshëm në komunikimin publik, jo vetëm përmes rrjeteve sociale, por edhe përmes daljeve në media dhe formateve të ndryshme publike, përfshirë Top Channel, CNN dhe podcastin "Flasim".



Komunikimi publik i Ministrit të Mjedisit gjatë periudhës së analizuar paraqitet kryesisht i kufizuar veçanërisht në raport me intensitetin e debatit publik dhe protestave të zhvilluara për çështjen e Zvërnecit. Ndërsa protestat vijuan dhe çështja mori një vëmendje të konsiderueshme publike, reagimet e drejtpërdrejta të ministrit u shfaqën në mënyrë sporadike dhe kryesisht në momente kur presioni publik dhe institucional sapo kishte nisur të rritej.

Më 26 maj 2026, gjatë një takimi online me përfaqësues të Komisionit Europian, sipas njoftimit të Ministrisë dhe Agjencisë për Media dhe Informim, ministri deklaroi se në atë moment nuk ekzistonte një projekt përfundimtar i miratuar dhe nuk kishte një projekt në ndërtim.

Ndërkohë, më 11 qershor 2026, Jaupaj foli në Kuvend për çështjen e Zvërnecit, duke mbrojtur qëndrimin institucional lidhur me projektin dhe procedurat mjedisore.

Në këtë kuadër, problemi nuk qëndron në mungesën absolute të komunikimit, por në ritmin, vazhdimësinë dhe natyrën e tij. Përballë një debati që kërkonte sqarime të vazhdueshme mbi statusin e projektit, procedurat mjedisore dhe ndikimin e tij në zonën e mbrojtur, komunikimi i ministrit mbeti kryesisht i kufizuar në reagime të veçuara dhe në mbrojtjen e qëndrimit institucional, në vend të një komunikimi të vazhdueshëm, proaktiv dhe shpjegues me publikun.

Kjo mungesë e një komunikimi të drejtpërdrejtë të Ministrit mund të vlerësohet në mënyrë kritike nga perspektiva e llogaridhënies dhe transparencës institucionale. Në një situatë ku një politikë publike e fushës së mjedisit është kundërshtuar publikisht dhe ka prodhuar protesta, pritet që ministri përgjegjës të shpjegojë politikën, të adresojë shqetësimet dhe të komunikojë drejtpërdrejt me publikun. Ripostimi i deklaramëve të një figure tjetër politike nuk e zëvendëson një komunikim të tillë dhe mund të krijojë përshtypjen e delegimit të përgjegjësisë së komunikimit politik, në vend të marrjes së saj nga institucioni përgjegjës.

Në një çështje që ka vendosur përballë qytetarët, institucionet dhe interesat e zhvillimit ekonomik, mënyra se si reagojnë aktorët publikë është po aq e rëndësishme sa vetë vendimmarrja. Komunikimi institucional nuk duhet të shërbejë vetëm për të promovuar aktivitetin e qeverisë apo për të kundërshtuar narrativën e protestuesve, por mbi të gjitha për të dhënë përgjigje të qarta mbi shqetësimet që kanë nxitur protestën. Kjo përgjegjësi është veçanërisht e madhe për institucionet që kanë në funksion të tyre mbrojtjen e mjedisit. Kur një protestë zgjat për javë të tëra, përgjigjja nuk mund të kufizohet në postime, deklarata apo replika politike; ajo duhet të shfaqet në transparencë, argumentim dhe dialog institucional.

Në të kundërt, krijohet përshtypja se energjia institucionale është përqendruar më shumë në menaxhimin e perceptimit publik sesa në adresimin e substancës së konfliktit. Për këtë arsye, ky raport e konsideron



reagimin e aktorëve kryesorë jo thjesht si një çështje komunikimi, por si një tregues të drejtpërdrejtë të llogaridhënies, transparencës dhe gatishmërisë së institucioneve për t'iu përgjigjur qytetarëve.

6 REAGIMI I INSTITUCIONEVE

6.1 Procesi parlamentar

Çështja e zonave të mbrojtura dhe e ndryshimeve të miratuara në vitin 2024 është reflektuar edhe në veprimtarinë parlamentare gjatë vitit 2026, përmes depozitimit të nismave ligjore që synojnë ndërhyrjen në kuadrin ekzistues. Në këtë drejtim, janë identifikuar të paktën dy nisma parlamentare që lidhen drejtpërdrejt me këtë çështje.

Megjithatë, për qëllime të këtij raporti, është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet depozitimit të një nisme ligjore dhe shqyrtimit të saj nga Kuvendi, pasi ekzistenca e një projektligji nuk nënkupton automatikisht se ai është trajtuar në procesin parlamentar.

Një nga nismat është ajo e deputetes së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike Ina Zhupa, e depozituar në maj 2026, e cila kërkon shfuqizimin e Ligjit nr. 21/2024, që solli ndryshime në Ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura". Sipas argumentimit të deputetes Zhupa, qëllimi i nismës është rikthimi i standardeve të mbrojtjes së zonave të mbrojtura në përputhje me Kushtetutën, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, konventat ndërkombëtare dhe standardet evropiane për mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë natyrore.

Nisma e dytë, e depozituar në Kuvend dhe e protokolluar me nr. 2585, nga deputet Redi Muçi, përbën një tjetër ndërhyrje të propozuar në kuadrin ligjor që rregullon zonat e mbrojtura në të cilën kërkohet shfuqizimi i ndryshimeve nr.21/2024 që i janë bërë ligjit nr.81/2017 "Për zonat e mbrojtura", me arsyetimin se bazuar në ndryshimet që i janë bërë ligjit të sipërcituar në 2024, është bërë e mundur ndërhyrja mbi ekosistemin mjedisor që ka ndodhur në zonën Pishë-Poro-Nartë

Megjithatë, elementi më i rëndësishëm nga pikëpamja e monitorimit parlamentar është statusi i këtyre nismave. Deri në periudhën e analizuar, ato nuk janë shqyrtuar në seancë plenare. Në qershor 2026, deputetja Zhupa deklaroi në Kuvend se projektligji i depozituar më 14 maj nuk kishte marrë ende një datë për shqyrtim në komisionet parlamentare apo në seancë plenare

Për rrjedhojë, nga pikëpamja institucionale, mund të thuhet se Kuvendi ka pasur një reagim në nivelin e nismës ligjvënëse, por deri në fund të periudhës së monitorimit nuk ka pasur një vendimmarrje plenare mbi shfuqizimin ose ndryshimin e Ligjit nr. 21/2024.



Kjo krijon një dallim të rëndësishëm ndërmjet kërkesave të artikuluar nga protestuesit dhe një pjese të opozitës, nga njëra anë, dhe qëndrimit të qeverisë, nga ana tjetër. Shfuqizimi i ndryshimeve të vitit 2024 është bërë një prej kërkesave të artikuluar publikisht nga protestuesit dhe është mbështetur edhe nga deputetë të opozitës.

Nga ana tjetër, Kryeministri Edi Rama ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm. Gjatë Konferencës së IX Ndërqeveritare Shqipëri–BE në Bruksel, Kryeministri Edi Rama sqaroi se ligji për Investimet Strategjike do të shfuqizohet, pasi ka përmbushur misionin e tij, ndërsa ligji për Zonat e Mbrojtura do të rishikohet dhe përshtatet me standardet e Bashkimit Europian. *“Shfuqizimi nënkupton anulim. Ligji për Investimet Strategjike do të shfuqizohet dhe anulohet, ndërsa ligji për Zonat e Mbrojtura, që është një nga ligjet më të mira që kemi, do të përshtatet derisa të arrijë 100% standardet europiane”*, u shpreh Kryeministri Rama.

Kjo diferencë është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e integritetit evropian. Nëse qeveria argumenton se zgjidhja është përafrimi i ligjit me standardet e BE-së, atëherë një nga çështjet kryesore për t'u monitoruar është përmbajtja konkrete e ndryshimeve që do të propozohen, dhe jo vetëm deklaratat politike për përafrim. Në veçanti, duhet të vlerësohet nëse ndryshimet e ardhshme do të forcojnë mekanizmat e mbrojtjes, do të vendosin kufij më të qartë për ndërhyrjet turistike dhe ndërtimore dhe do të garantojnë se zhvillimi ekonomik nuk prevalon mbi objektivin e ruajtjes së biodiversitetit.

6.2 Transparenca institucionale

Një element tjetër i rëndësishëm në vlerësimin e reagimit institucional është transparenca dhe garantimi i së drejtës së publikut për t'u informuar. Në korrik 2026, Qendresa Qytetare i ka drejtuar Ministrisë së Mjedisit një kërkesë për informacion lidhur me çështjet që qëndrojnë në themel të protestave, duke kërkuar të dhëna konkrete mbi verifikimet dhe inspektimet e kryera për projektet në Nartë dhe Zvërnec, përputhshmërinë e tyre me legjislacionin shqiptar dhe angazhimet evropiane, qëndrimin e Ministrisë ndaj kritikave të Parlamentit Evropian, nismat për adresimin e këtyre rekomandimeve, mundësinë e rishikimit të kuadrit ligjor dhe procedurave të miratimit të projekteve, si dhe konsultimet me komunitetin lokal dhe organizatat mjedisore.

Kërkesa nuk synonte marrjen e një qëndrimi politik nga Ministria, por informacion mbi veprimet konkrete të institucionit dhe mënyrën se si është ushtruar përgjegjësia e tij publike. Për këtë arsye, mosdhënia e një përgjigjeje deri në përfundim të periudhës së monitorimit përbën një element që duhet evidentuar në raport, veçanërisht duke pasur parasysh natyrën e çështjes dhe interesin e lartë publik që ajo ka krijuar.



Në këtë rast, transparenca nuk është një element dytësor i komunikimit institucional. Informacioni mbi inspektimet, procedurat mjedisore, përputhshmërinë e projekteve me ligjin dhe angazhimet evropiane është i domosdoshëm që publiku të mund të vlerësojë nëse vendimmarrja është kryer në mënyrë të ligjshme, të argumentuar dhe të përgjegjshme. Në mungesë të këtij informacioni, hapësira publike mbetet e mbushur kryesisht me deklarata politike dhe narrativa të kundërta, ndërsa të dhënat institucionale që do të mund të sqaronin vetë konfliktin mbeten të padisponueshme për publikun.

Kjo merr një rëndësi të veçantë edhe në raport me të drejtën për informim, pasi transparenca e institucioneve publike nuk duhet të aktivizohet vetëm kur informacioni është në funksion të promovimit të punës së tyre. Ajo duhet të jetë veçanërisht e fortë në rastet kur ekziston një interes i lartë publik, një konflikt i zgjatur social dhe pyetje konkrete mbi ligjshmërinë dhe ndikimin mjedisor të vendimmarrjes. Në këtë kuptim, mungesa e përgjigjes ndaj kërkesës për informacion nuk mund të shihet thjesht si një boshllëk në komunikim, por si një çështje që prek drejtpërdrejt llogaridhënien institucionale dhe aftësinë e qytetarëve për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e tyre për t'u informuar.

Për më tepër, pyetjet e dërguara lidhen drejtpërdrejt me vetë objektin e protestës. Prandaj, një përgjigje institucionale do të kishte shërbyer jo vetëm për të përmbushur detyrimin e transparencës, por edhe si mekanizëm për të ulur pasigurinë dhe mosbesimin publik. Nëse Ministria ka kryer verifikime, inspektime, konsultime apo ka ndërmarrë hapa për përafrimin me standardet evropiane, këto janë të dhëna që publiku duhet të ketë mundësi t'i njohë dhe t'i verifikojë.

Në një konflikt ku një nga akuzat kryesore është mungesa e transparencës në vendimmarrjen për zonat e mbrojtura, heshtja e institucionit përgjegjës ndaj një kërkesë konkrete për informacion krijon një paradoks institucional: pikërisht në momentin kur publiku kërkon më shumë prova, dokumente dhe përgjigje, informacioni institucional mbetet i munguar.

6.3 Reagimi i institucioneve evropiane

Çështja e zonave të mbrojtura në Shqipëri ka marrë një rëndësi të veçantë edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Qëndrimi i Parlamentit Evropian u konkretizua më tej më 17 qershor 2026, kur u miratua amendamenti 46a, i cili e lidhi në mënyrë të drejtpërdrejtë situatën në zonën e mbrojtur Vjosë-Nartë me pasojat praktike të ndryshimeve të kuadrit ligjor. Në amendament, Parlamenti Evropian shprehu shqetësim serioz se zhvillimet në Vjosë-Nartë demonstrojnë pasojat konkrete të ndryshimeve legjislative dhe rreziqet që këto zhvillime paraqesin për zona me vlera të njohura ekologjike. Në mënyrë të veçantë, Parlamenti Evropian



deklaroi se po ndiqte nga afër protestat masive paqësore të zhvilluara lidhur me këtë çështje.

Elementi më i rëndësishëm i këtij qëndrimi është kërkesa për vendosjen e menjëhershme të një moratoriumi. Parlamenti Evropian i bëri thirrje autoriteteve shqiptare që të vendosin një moratorium mbi të gjitha procedurat e reja të dhënies së lejeve, punimet e reja të ndërtimit dhe ndërhyrjet e reja zhvillimore brenda zonave të mbrojtura. Sipas formulimit të amendamentit 46a, moratoriumi duhet të qëndrojë në fuqi deri në shfuqizimin e dispozitave të ndryshuara të Ligjit për Zonat e Mbrojtura që konsiderohen të papajtueshme me standardet evropiane, si dhe deri në sigurimin e pajtueshmërisë së plotë me standardet e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e natyrës.

Kërkesa për moratorium është veçanërisht e rëndësishme në analizën e protestave, pasi tregon se shqetësimet e ngritura nga protestuesit, organizatat mjedisore dhe shoqëria civile nuk janë trajtuar vetëm si një konflikt i brendshëm politik apo si kundërshtim ndaj projekteve të veçanta. Përkundrazi, këto shqetësime kanë hyrë në vëmendjen e drejtpërdrejtë të institucioneve evropiane dhe janë lidhur me detyrimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit. Në këtë kontekst, moratoriumi mund të kuptohet si një masë parandaluese: synimi është që ndërhyrjet e reja në zonat e mbrojtura të pezullohen derisa të rishikohet kuadri ligjor dhe të garantohet përputhshmëria e tij me standardet evropiane të mbrojtjes së natyrës. Kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht një ndalim të përhershëm të çdo aktiviteti ekonomik apo turistik në këto zona, por një ngrirje të procedurave dhe ndërhyrjeve të reja deri në përmbushjen e kushteve të kërkuara nga Parlamenti Evropian.

Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë përbëjnë një nga instrumentet kryesore për vlerësimin e progresit të vendit në procesin e integritetit. Në fushën e mjedisit, vëmendja është përqendruar në nevojën për forcimin e mbrojtjes së biodiversitetit, administrimin efektiv të zonave të mbrojtura dhe përafrimin e kuadrit shqiptar me acquis-in evropian.

Kjo çështje mori një rëndësi edhe më të madhe pas ndryshimeve të vitit 2024 në Ligjin "Për zonat e mbrojtura".

Në raportin e Parlamentit Evropian mbi raportet e Komisionit për Shqipërinë, është shprehur shqetësim serioz për ndryshimet e fundit në ligjin shqiptar, duke vënë në dukje se ato lejojnë projekte të mëdha infrastrukturore dhe turistike në zona me ndjeshmëri ekologjike. Parlamenti Evropian ka shprehur shqetësim të drejtpërdrejtë lidhur me ndryshimet në Ligjin për Zonat e Mbrojtura dhe ka kërkuar që ato të rishikohen për të garantuar përputhshmërinë me standardet e mbrojtjes së natyrës.

Qëndrimi i Parlamentit Evropian duhet parë gjithashtu në vazhdimësi me shqetësimet e shprehura më herët për zonat e mbrojtura në Shqipëri. Në



rezolutën e vitit 2023 mbi Raportin e Komisionit për Shqipërinë, Parlamenti Evropian kishte kërkuar përmirësimin e transparencës, zbatimit dhe monitorimit të vlerësimeve të ndikimit në mjedis dhe vlerësimeve strategjike mjedisore, veçanërisht për projektet me ndikime të mëdha mjedisore dhe socio-ekonomike. Po në atë rezolutë, Parlamenti kishte kërkuar nga qeveria shqiptare marrjen e masave urgjente për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit dhe kishte bërë thirrje për ndalimin e projekteve që rrezikojnë të shkelnin normat kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit, duke përmendur në mënyrë të veçantë Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës dhe zhvillimet hidroenergjetike në zonat e mbrojtura.

Në këtë perspektivë, zhvillimet në Vjosë-Nartë kanë shërbyer si një nga rastet konkrete përmes të cilave është materializuar debati mbi përputhshmërinë e zhvillimit ekonomik me mbrojtjen e natyrës.



GJETJET KRYESORE

- 01** Ndryshimet e vitit 2024 kanë krijuar një debat mbi vetë filozofinë e menaxhimit të zonave të mbrojtura. Ndërsa ligji i vitit 2017 e vendoste theksin te konservimi, ndryshimet e vitit 2024 krijojnë një model ku mbrojtja e natyrës dhe zhvillimi ekonomik vendosen më qartë në një raport balancimi. Kjo ngre shqetësime mbi kufirin praktik ndërmjet "zhvillimit të qëndrueshëm" dhe zhvillimit intensiv turistik.
- 02** Reagimi institucional ka qenë i pabarabartë. Nga 47 postime të Ministrit të Mjedisit, 14 (29,8%) lidhen me protestat/protestuesit, por vetëm 2 janë postime origjinale, ndërsa 12 janë ripostime.. Në kontrast, Kryeministri publikoi 119 postime, nga të cilat 71 (59,7%) ishin meme ose komente ironizuese ndaj protestuesve dhe 18 (15,1%) reagime të drejtpërdrejta ndaj protestave. Kjo krijon një diferencë ndërmjet përgjegjësisë politike për komunikimin dhe përgjegjësisë institucionale për adresimin teknik të çështjes.
- 03** Në nivel parlamentar ka pasur nisma për shfuqizimin e ndryshimeve të vitit 2024, por ato nuk janë materializuar ende në vendimarrje plenare. Dy nisma të depozituara, përfshirë atë të Ina Zhupës dhe atë të Redi Muçit, synojnë shfuqizimin e Ligjit nr. 21/2024. Megjithatë, deri në fund të periudhës së monitorimit, këto nisma nuk ishin shqyrtuar në seancë plenare dhe nuk kishte një vendimarrje parlamentare për ndryshimin ose shfuqizimin e ligjit.



04 Qëndrimi i qeverisë është orientuar drejt rishikimit dhe përafrimit të ligjit me standardet evropiane, jo drejt shfuqizimit të tij. Kryeministri ka deklaruar se Ligji për Zonat e Mbrojtura do të përshtatet me standardet e BE-së, duke përjashtuar mundësinë e shfuqizimit të tij. Për këtë arsye, mbetet për t'u parë nëse angazhimi politik do të përkthehet në ndryshime konkrete që forcojnë mbrojtjen e biodiversitetit dhe vendosin kufij më të qartë për ndërhyrjet zhvillimore.

05 Mangësi në zbatimin e standardeve evropiane për mbrojtjen e natyrës. Shqipëria ka bërë hapa në përafrimin e kuadrit ligjor me *acquis-in* e BE-së, por mbetet një hendek ndërmjet kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij në praktikë. Problematikat lidhen veçanërisht me mbrojtjen efektive të zonave të mbrojtura, vlerësimet e ndikimit në mjedis dhe autorizimin e projekteve turistike e infrastrukturore në zona ekologjike të ndjeshme

06 Transparenca institucionale mbetet një element për t'u përmirësuar. Qëndresa Qytetare i ka drejtuar Ministrisë së Mjedisit kërkesë për informacion mbi inspektimet, përputhshmërinë e projekteve në Nartë dhe Zvërnec, qëndrimin ndaj rekomandimeve evropiane dhe konsultimet me komunitetin dhe organizatat mjedisore. Deri në periudhën e monitorimit nuk ishte administruar përgjigje, duke e bërë këtë një çështje që kërkon ndjekje të mëtejshme në kuadër të transparencës dhe së drejtës për informim.



REKOMANDIME

1 Të rishikohet Ligji nr. 81/2017, së bashku me ndryshimet e vitit 2024, në funksion të një përafrimi të plotë me *acquis-in* evropian, veçanërisht me standardet e mbrojtjes së habitateve dhe biodiversitetit në kuadër të Kapitullit 27.

2 Të përcaktohen më qartë kufijtë ndërmjet mbrojtjes së zonave të mbrojtura dhe zhvillimit ekonomik/turistik, në mënyrë që koncepti i "zhvillimit të qëndrueshëm" të mos krijojë hapësira të paqarta për ndërhyrje intensive në terriore me vlera të larta ekologjike.



- 3 Të forcohen mekanizmat e vlerësimit dhe kontrollit mjedisor për projektet që parashikohen në zona të mbrojtura, duke garantuar që vendimmarrja të mbështetet në të dhëna shkencore, vlerësime të plota mjedisore dhe parimin e kujdesit.
- 4 Të rritet transparencja e Ministrisë së Mjedisit, veçanërisht lidhur me inspektimet, lejet, vlerësimet mjedisore, projektet në zonat e mbrojtura dhe masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve evropiane.
- 5 Të garantohej konsultimi real me komunitetet lokale, organizatat mjedisore dhe ekspertët, veçanërisht për projektet që mund të ndikojnë në biodiversitet dhe integritetin e zonave të mbrojtura.
- 6 Kuvendi të sigurojë shqyrtimin në kohë të nismave parlamentare që lidhen me Ligjin nr. 21/2024 dhe të garantojë një proces transparent, publik dhe të argumentuar të shqyrtimit të tyre. Aktualisht, depozitimi i nismave nuk është shoqëruar ende me një vendimarrje plenare.



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al